

UDHEZUES TATIMESH PER TE HUAJT



KOD FISKAL, TESERA SHËNDETSORE E LLOGARIE TATIMORE
CODICE FISCALE, TESSERA SANITARIA E PARTITA IVA
DEKLARATA E TË ARDHURAVE
DICHIARAZIONE DEI REDDITI
FAMILJARËT NË NGARKIM
FAMILIARI A CARICO
REDUKTIMET E TAKSAVE
LE RIDUZIONI D'IMPOSTA
BLERJA DHE QIRAJA E SHTËPISË
ACQUISTO E AFFITTO CASA
INFORMACIONE DHE ASISTENCË FISKALE
INFORMAZIONI E ASSISTENZA FISCALE

UDHËZUES TATIMESH PËR TË HUAJT

KOD FISKAL, TESERA SHËNDETSORE
E LLOGARIE TATIMORE

DEKLARATA E TË ARDHURAVE

FAMILJARËT NË NGARKIM

REDUKTIMET E TAKSAVE

BLERJA DHE QIRAJA E SHTËPISË

INFORMACIONE DHE ASISTENCË FISKALE



TREGUESI

1. **DUHET TË KEM NJË KOD FISKAL?** 4
C'është tesera shëndetsore?
2. **CFARË DUHET BËRË KUR FILLOHET NJË AKTIVITET?
KAM NEVOJË PËR NJË HAPJE LLOGARIE TATIMORE?** 6
3. **JAM NJË PUNONJËS I NDËRVARUR:
DUHET TË PAGUAJ TATIMET?** 7
Edhe pse jam një bashkpunëtorë shtëpiake, ose kujdestare për të moshuarit?
4. **PUNOJ PËR LLOGARINE TIME:
DUHET TË PAGUAJ TATIMET?** 8
Duhet të mbaj llogaritë?
Dhe në qoftë se filloj një aktivitet të ri?
Kush mundet të më ndihmojë? (tutor)
5. **NË Ç'MËNYRË DUHET TË DEKLAROJ FITIMET?** 10
Në qoftë se jam një punonjës i ndërruar, ose një pensionist?
(modeli 730)
Në qoftë se nuk jam një punonjës i ndërruar, apo një pensionist
(modeli i Vetëm)
6. **SI BËHET E MUNDUR QË TË PAGUAJ SA MË PAK TAKSA? 14
ZBRITJET DHE ZVOGELIMET**
Zbritjet për familjarët mbi ngarkim
Zbritje të tatimet prej për 19%: shpenzime mjekësore, interesa pasive
mbi kreditë për blerjen e shtëpisë së parë, shpenzime për shkollim
Zbritje për shtëpinë e parë
Shtesë page periodike për mbajtjen ekonomike të bashkëshortes
së ndarë apo të divorcuar
Kontribute pensioni ose asistence
7. **BLE NJË SHTËPI: KAM KUSHTE LEHTËSUESE?** 16
8. **DHE NË QOFTË SE E MARR ME QIRA? (QIRA TË KONVENCIONUARA)** 18
9. **JAM PRONAR I NJË SHTËPIE:
DUHET TË PAGUAJ TAKSA MBI SHTËPISË?** 18
10. **AGJENSIA E HYRJEVE: SHËRBIME,
INFORMAZIONE DHE ASISTENCË** 19

1. DUHET TË KEM NJË KOD FISKAL?

Në qoftë se je qytetar italian, apo i huajt që jeton në Itali, duhet të kesh kod fiskal. Kod fiskal shërben për të qënë i identifikuar nga institucionet dhe administratat shtetërore. Kod fiskal merret nga Zyrat lokale të Agjencisë për Hyrjet, nëpërmjet prezantimit të një dokumenti rinjohës të vlefshëm:

- për të huajt jo komunitarë të Komunitetit European, shërben pasaporta me vizat e shënuara sipër, ose leja e qëndrimit (il permesso di soggiorno);
- për të porsalindurit është e mjaftueshme çertifikata e lindjes, apo vetëçertifikimi i prindit.

Megjithatë, kujtohu që për të patur një kod fiskal duhet të kesh kartën ose lejen e qëndrimit. Në qoftë se ke ngelur për të patur kod fiskal, por nuk ke marrë akoma një dokument për leje qëndrimi, mundet të kërkosh në Zyrën e Agjencisë së Hyrjeve kompetente informacione që i përkasin kushteve të nevojshme që duhen përbushur për të patur gjithësesi kod fiskal.

Në rast se humbet tesera e kod fiskal, mundet të kërkosh dublikimin e saj pranë Zyrës lokale të Agjencisë së Hyrjeve. Si alternativë, në qoftë se dëshiron të evitosh radhat, apo nuk mundet të shkosh pranë kësaj Zyre, mundet që ta kërkosh dublikatën direkt nëpërmjet Internetit mbi sitin e Agjencisë së Hyrjeve:

www.agenziaentrate.gov.it (shtyp mbi zërin Shërbime - kod fiskal - kërko dublikimin e kod fiskal).

Në qoftë se vëren që K. T. i juaj është i gabuar, sepse nuk korrispondon me mbiemrin apo emrin tënd, duhet drejtuar praë Zyrës për ta korrigjuar. Në qoftë se je shkruajtur në zyrën e regjistrimit civil ku jeton, tesera e re e plastifikuar do të dërgohet brenda pak kohe në adresën ku njihesh si banues. Në qoftë se nuk të arrin në shtëpi, duhet ti drejtohesh një Zyre lokale të Agjencisë për të verifikuar që kod fiskal ku banon është shënuar në mënyrë korrekte, ose për të komunikuar ndryshimet që munden të jenë berë.

Kështu që mundet të kërkosh kod fiskal:

- Ku? Pranë zyrave lokale të Agjencisë së Hyrjeve
- Si? Mbi modelin që merret pranë Zyrës ku duhet të plotësosh kërkesën në të gjitha pjesët, dhe duhet të paraqitesh një dokument identifikues.

DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR TË PASUR KOD FISKAL

TË MITURIT	PËR TË HUAJT Jo komunitarë	PËR TË HUAJT komunitarë
<ul style="list-style-type: none"> • dokument identifikues të prindit • Dokument i të miturit • ose vetëcertifikim del genitore 	pasaportë ose leje qëndrimi	dokument identifikues

Deklarata autocertificazione, është e pranueshme vetëm nga ana e subjekteve që jetojnë në Itali ose kanë lindur në Itali, elemente pra të verifikueshme. Për personat e lindur në vëndet jashtëkomunitare certifikatat e lëshuara nga këto vënde duhet të përkthehen dhe të legalizohen nga autoritetet konsullore italiane në ato vënde.

C'është tesera shëndetsore?

Ministria e Ekonomisë dhe e Financave, në bashkëpunim me Agjensinë e Hyrjeve, është duke përfunduar dorzimin e tesarave shëndetsore për të gjithë qytetarët që kanë të drejtë për asistencë shëndetsore.

Tesera Shëndetsore, përveç të dhënave vetjake dhe asistenciale, dhe kod fiskal në format alfanumerik dhe në formatin elektronik “bar-code” dhe do të zëvendësojë gradualisht atë të plastifikuar egzistente. Pra ka një rol të dyfishtë: teser shëndetsore dhe kod fiskal, për ta përdorur në të gjitha rastet por dhe instrument për të shfrytëzuar shërbimet shëndetsore.

Tesera ka një afat prej 5 vjetësh, me përjashtim të Rajoneve të veçanta, dhe mund të përdoret në të gjithë territorin kombëtar dhe në vëndet e Bashkimit Europian, duke zëvendësuar kështu modelin prej letre E111.

Kur arrin momenti i skadencës, vetë Agjensia e Hyrjeve dërgon automatikisht në adresën e regjistruar në arkivin e saj Teserën e re për të gjithë ata që ju vazhdon asistencën.

Nëse të dhënat vetjake në teser janë të gabuara, vetë qytetari mund ti drejtohet çdo lloj zyre të Agjensisë së Hyrjeve për ta korrigjuar. Edhe për raste

prishje ose humbje të tesserës mund të kërkohet një dublikat.

Për të ditur më tepër mund të telefononi në numurin jeshil 800-030-070 ose mund të konsultoni sitin www.sistemats.it

2. CFARË DUHET BËRË KUR FILLOHET NJË AKTIVITET? KAM NEVOJË PËR NJË HAPJE LLOGARIE TATIMORE?

Në qoftë se dëshiron të fillosh një aktivitet si ndërrmarrës, artist apo profesionist, duhet ta komunikosh në Agjencinë e Hyrjeve duke plotësuar një model të caktuar, që gjendet pranë Zyrove ose mbi sitin në Internet të Agjencisë së Hyrjeve: www.axgenziaentrata.it (mbi zërin Modulistica (modelet)- modele të tjera).

Duhet të paraqesësh deklaratën e fillimit të aktivitetit edhe pse nuk banon në Itali, por dëshiron që të ngresh këtu një organizim stabil, apo që dëshiron të jesh i identifikuar nga Administrata në mënyrë direkte, pa u pajisur nga një paraqitje tatimore. Deklarata e fillimit të aktivitetit duhet të paraqitet brënda 30 ditëve nga data e fillimit dhe, që i takon me operacionin e parë (psh: blerja e instrumentave që shërbejnë) ose që lidhet me një tjetër ngjarje të finalizuar mbi veprimet kryesore mbi aktivitetin (psh: nënshkrimi i kontratës të lokalit). Kur prezanton deklaratën e fillimit të aktivitetit, mbas një sërë kontrollesh, të jipet nga ana e Agjencisë së Hyrjeve një numur provizor i hapjes së llogarisë (Iva), që nuk do ta ndryshosh deri në momentin e mbylljes së aktivitetit.

Kini kujdes: duke filluar nga 1 janari 2007, nëse vëllimi i biznesit nuk kalon shifrën prej € 7.000 dhe nuk kryheni eksportime, mund të zgjidhni një regjim IVA të lehtësuar, ku nuk paguhet përqindja e IVA dhe thjeshtësohen kërkesat (qubet "regjim i frankixbas"). Vëllimi i biznesit del nga shuma e plotë e prodhimit (dhënies) së të mirave dhe shërbimeve në një vit të caktuar. Përjashtohen nga ky regjim i thjeshtuar ata që nuk janë banues në Itali dhe punojnë në territorin e shtetit nëpërmjet përfaqësuesve tatimorë ose me identifikim direkt.

Në qoftë se je një subjekt i ndryshëm nga një person fizik (shoqëri, shoqatë, komitet,...) dhe, në aktin e paraqitjes së deklaratës të fillimit të aktivitetit, nuk ke kod fiskal, numri i llogarisë Iva fiton barasvlerën e kod fiskal.

Duhet të komunikosh edhe, të gjitha ndryshimet e më pastajme të të dhënave që shënohen në deklaratën e fillimit të aktivitetit (duke përmbledhur edhe mbylljen e aktivitetit) direkt pranë Zyrove të Agjencisë të Hyrjeve

brënda 30 ditëve nga data kur ka pësuar ndryshime, me të njëjtat mënyra që parashikohen për fillimin e aktivitetit. Nuk duhet harruar që duhet drejtuar edhe pranë institucioneve të tjera për të kompletuar praktikën që bën të mundur fillimin e aktivitetit (psh: Dhoma e Tregëtisë, Inps, etj.)

3. JAM NJË PUNONJËS I NDËRVARUR: DUHET TE PAGUAJ TATIMET?

Ne qoftë se zhvillon një aktivitet tëndin që varet nga një tjetër subjekt i cili mundet të jetë një ndërmarrje, një institucion shtetëror apo privat, një pjesë e fitimit tënd duhet ti derdhet Shtetit si taksë mbi të ardhurat. Në këtë rast nuk duhet të preokupohesh pse derdh mbi taksat, sepse duhet të jetë punëdhënësi juaj ai që duhet ta bëjë në vendin tënd. Punëdhënësi, në fakt, mban nga rroga që duhet të merrni një pjesë të lekëve (pjesa e hequr), e cila do të derdhet direkt në Shtet si taksë. Në këtë rast nuk je i detyruar të prezantosh deklaratën e të ardhurave (modeli i Vetëm, ose modeli 730, shih kapitullin 5).

Duhet të kujtohesh veç, që ke të ardhura të tjera (psh: ke një shtëpi ndryshe nga ajo që është e destinuar për banim kryesor, zhvillon punë të tjera në moment etj). Duhet ti shënosh në deklaratë dhe duhet të paguash taksat relative.

Edhe pse jam një bashkpunëtorë shtëpiake, ose kujdestare për të moshuarit?

Në qoftë se dëshiron të punësohesh si bashkëpunëtorë shtëpiake apo kujdestare duhet të nënshkruash një kontratë të rregullt pune (apo letër punësimi) sëbashku me punëdhënësin tuaj. Për të nënshkruar këtë kontratë duhet të kesh këto dokumenta që vijojnë: dokument identifikues, një diplomë, teseren shëndetësore dhe kod fiskal. Në qoftë se je një person që nuk bën pjesë në komunitetin evropian duhet të kesh edhe lejen e qëndrimit (permesso di soggiorno). Mbase të jetë bërë punësimi, i komunikohet Inail (sigurimi kundër dëmtimeve) nga ana e punëdhënësit.

Ky raport pune duhet të tregohet edhe tek Inps (për mbulimin e pensionit) për të cilin derdhen kontribute çdo trimestër. Për sa i përket taksave, punëdhënësi nuk mundet të kryejë zbritje tatimore. Ka si detyrim, ti lëshojë punëtorit një deklaratë relative për derdhjet që bëhen gjatë gjithë vitit. Kështu që në dallim nga punonjësit e tjerë të ndërvarur, përveçse deklarimit në fund

të vitit për çka ke fituar duhet të paguash edhe taksat që të takojnë, dhe jo atëherë kur punëdhënësi i mban nga rroga jote. Në këtë rast, duhet të plotësosh një model i Vetëm (shih kapitullin 5) gjithmonë në qoftë se të ardhurat e tua për këtë vit superojnë limitet që janë caktuar nga ligjet.

4. PUNOJ PËR LLOGARINE TIME: DUHET TË PAGUAJ TATIMET?

Në qoftë se punon për llogarinë tënde sepse je profesionist i lirë, ke një dyqan, apo një ndërmarrje personale, duhet që çdo vit të derdhësh taksat duke i shënuar në deklaratë (shih kapitullin 5 modeli i Vetëm) të ardhurat e tua.

Duhet të mbaj llogaritë?

Me kërkesën për fillimin e numrit të llogarisë, sipas vëllimit të punëve që kryen dhe në bazë të përmasave të aktivitetit tënd, duhet të zgjedhësh ndërmjet regjimesh të ndryshme kontabiliteti.

Kini kujdes: duke filluar nga 1 janari 2007, parashikohet një regjim i mospagimit të Iva për personat që ushtrojnë aktivitete, tregëtare, bujqësore dhe profesionale dhe që parashikojnë të realizojnë ose kanë realizuar (në vitin e kaluar) një vëllim biznesi jo më të madh se sa € 7.000,00.

Për të përcaktuar llojin e regjimit, mund të këshilloheni me punonjësit e Agjencisë së Hyrjeve ose mund ti drejtoheni shoqatës së kategorisë suaj.

Dhe në qoftë se filloj një aktivitet të ri?

Për aktivitetet e reja që nisin si ndërmarrje individuale, punishte familjare apo punonjës të pavarur është parashikuar një regjim zëvendësues. Në qoftë se adopton këtë lloj regjimi do të kesh një tatim më të vogël, sepse do të derdhësh një taksë zëvendësuese të Irpef të barabartë me 10% të të ardhurave që ke prodhuar. Duhet të kesh kujdes veç, sepse janë dhe taksat zëvendësuese e Irpef si dhe shtojcat rajonale dhe komunale, kështu që duhet të derdhësh të tjera taksa. Ky regjim zgjat maksimumi 3 vjet dhe aplikohet duke filluar nga viti i parë i fillimit të aktivitetit. Për të adoptuar këtë lloj regjimi duhet të plotësosh një model të posaçëm. Këtu në ndjekje do të gesh pikat kryesore të kontabilitetit si dhe kërkesat që duhen për të hyrë në këtë regjim.

INICIATIVAT E REJA PRODHUESE	Ndërmarrje individuale	KERKESAT	REGJISTRI
		<ul style="list-style-type: none"> - mungesa e funksionimit në tre vitet e fundit si aktivitet ndërmarrës - aktivitet që nuk ndjek një aktivitet tjetër që është kryer më parë - fitime jo superiore në euro 30.987,41 (PËR AKTIVITETE DHËNIE SHËRBIMESH) OSE NË euro 61.974,83 (PËR AKTIVITETE TË TJERA) 	<ul style="list-style-type: none"> - asnjë regjistër, por vetëm një pasqyrë e thjeshtë për të mirat amortizuese - detyrim për të faturuar, çertifikimi i korrisponduesve (SE ËSHTË E PARASHIKUAR), ruajtja e dokumentave të marra dhe të dhëna, prezantimi i deklaratës të së ardhurave dhe kryerjen e derdhjeve vjetore

*Aktiviteti nuk duhet të zëvendësojë një vazhdim të thjeshtë të aktiviteteve paraardhëse në formën e punës së ndërvarur ose autonome. Nëse bëhet fjalë për vazhdimin e aktivitetit të një ndërmarrjeje të kryer nga një subjekt tjetër (p. sh. dorëzim i një ndërmarrjeje) të ardhurat e marra në periudhën paraardhëse nuk duhet të kalojnë shifrën prej euro 30.987, 41 nëse ndërmarrja ofron shërbime ose shifrën prej 61.974,83 nëse ndërmarrja kryen një aktivitet tjetër.

Kush mundet të më ndihmojë? (tutor)



Në qoftë se fillon një aktivitet të ri apo punë autonome dhe ke një ndërmarrje të vogël , ose ke një ndërmarrje që përdor një regjim zëvendësues për aktivitete të dorës së dytë, Agjencia e Hyrjeve të vë në dispozicion një shërbim të rëndësishëm: “Tutorim” (mbështetje).

Ky është një shërbim asistencial falas që të ndihmon për kryerjen detyrimeve kryesore për taksat.

Për të përdorur këtë shërbim duhet shkuar në zyrat lokale që gjëndet në vëndin ku keni tatimorin shtëpiak, ose mundet të lidheni me sitin e Agjencisë nëpërmjet internetit.

Në çdo zyrë është një “tutor”, dmth, një person që dë të ndihmojë për të

kuptuar cilat janë detyrimet e tua përballë Tatimor , si psh llogaria e taksave, plotësimin e deklaratës si dhe mënyrat e derdhjeve. Mbasi të keni kërkuar asistencën, duhet të merrni një kod personal (kodi PIN) dhe nje fjalë hyrëse sekrete (pasWord).

Duhet të kujtohesh, që për të patur një tutor, duhet të nxjerrësh nga faqja e internetit mbi sitin e Agjencisë, kështu që duhet të keni një PC (kompjuter) të lidhur me Internetin. Në këtë mënyrë mundet të komunikoni me Agjencinë të gjitha të dhënat e llogarisë tuaj të cilat do të kontrollohen dhe përdoren për plotësimin e deklaratës së të ardhurave.

5. NË Ç'MËNYRË DUHET TË DEKLAROJ FITIMET?

Duhet komunikuar ajo çka fitohet duke paraqitur deklaratën e të ardhurave për çdo vit.

NË QOFTË SE JAM NJË PUNONJËS I NDËRVARUR OSE NJË PENSIONIST (MOD.730)

Mundet të deklarosh të ardhurat me modelin 730, duke përdorur asistencën:

- nga ana e punëdhënësit;
- nga ana e institucionit që të lëshon pensionin;
- nga ana e njërës qëndër të asistencës tatimore për punonjësit e ndërvarur dhe pensionistët (të quajturit Caf) të përbërë nga shoqatat e sindakatave apo të punëdhënësve. Tek Caf duhet të prezantosh të gjithë dokumentat e nevojshme. Mundet ta gesh adresën e caf Rajonor tek siti i Internetit të Agjencisë së Hyrjeve (www.agenziaentrato.gov.it);
- për subjektet e aftësuar me asistencë fiskale (konsulentë pune, doktorë ose llogaritarë komercialistë, ekspertë të kontabilitetit).

Kujdes: jo të gjithë punonjësit e ndërvarur apo pensionistët mundin të përdorin modelin 730. Në veçanti, në qoftë se ke edhe të ardhura të tjera nga një ndërmarrje tjetër, apo të ardhura të tjera nga punë ku kryen profesione apo zanate të tjera, nuk mundet të përdorësh këtë model dhe duhet të prezantosh deklaratën e modelit të vetëm.

Në qoftë se je një punonjës me kontratë pune me kohë të shkurtër për një periudhë për më pak se një vit mundet të prezantosh modelin 730:

- zëvendësuesin e taksës vetëm kur raporti zgjat të paktën nga muaji prill deri në muajin korrik;
- vetëm CAF, nga një profesionisti aftësuar, qoftë se raporti i punës zgjat të paktën nga muaji qershor deri në muajin korrik.



Në qoftë se ke të ardhurat me bashkëpunim koordinativ dhe të vazhdueshëm mundet të përdorësh mod.730, me kusht që raporti i bashkëpunimit ndjek periudhën ndërmjet muajit qershor dhe muajit korrik. E veçanta e Mod.730 është që mundet të marrësh një kthim vlere nga taksat, që është mbajtur më tepër, direkt nga pagesa apo nga pensioni, duke filluar nga muaji korrik. Në rast se, ti duhet të paguash shuma, këto do të mbahen direkt nga pagesa apo nga pensioni, kështu që nuk duhet të preokupohesh për të berë ndonjë derdhje.

Kujt dhe kur duhet ti paraqesesh Mod.730?

Punëdhënësit ose Institucionit pensionistik (psh: Inps, Inpdap,...) Mod.730 duhet të paraqitet i plotësuar pa praninë e ndonjë dokumenti, ë të cilin megjithatë duhet ta ruash për 4 vjet.

Në qoftë se paraqet 730 ne Caf pa e plotësuar duhet të paguash atë çka kërkohet. Në qoftë se e dorëzon të plotësuar, Caf.it nuk i takon asnjë rikompensim. Në qoftë se i drejtohesh Caf.it, kujtohu që duhet të paraqesësh të gjitha dokumentat relative.


Në qoftë se kërkon asistencë për plotësim, po ashtu dorëzon modelin e plotësuar, duhet të japësh, edhe vetëm të fotokopjuar, dokumentat që vijojnë:

- CUD që lëshohet nga punëdhënësi apo nga sigurimet shoqërore për pensionistët si dhe çertifikata të tjera që zëvendësojnë për taksat nga të cilat dalin mbajtjet e mbajtura nga; të ardhurat e punës së pavarur, mbi të ardhurat e matura nga puna e ndërvarur, mbi të ardhurat e punës së pavarur stinore, etj;
- fatura, dokumenta, skontrina, që vërtetojnë mbështetjen e shpenzimeve gjatë vitit, për të cilën është parashikuar zbritja nga të ardhurat e përmbledhura, apo nga rinjohja e zbritjeve nga taksa lord (e plotë) (shih kapitullin e ardhshëm);
- tjetër dokument i nevojshëm për njohjen e disa shpenzimeve zvogëluese, si psh, për interesat passive që i paguan në bankë për kredi të marra për blerjen e një shtëpie, duhet paraqitur kopja e kontratës së kredisë: për sigurimet mbi jetën, kopja e dokumentit të bërë, ose ndonjë dokument tjetër që është lëshuar nga kompania e sigurimeve në të cilën vihen re të dhënat që duhen për zbritjen relative që kryhet, etj;

- për shpenzimet që janë bërë për rindërtimin e ndërtesave (zbritje 36%: kap.10), letra e rekomanduar, e dërguar në Qëndrën vepruese për të komunikuar fillimin e punëve, dokumentin e të ardhurave bankare nëpërmjet te clave janë paguar veprat e rindërtuara(riparuara), dokumenti i lëshuar nga shtëpia (në rast pune për riparie të urdhëruara nga pjesë të përbashkëta);
- deklarata e fundit e deklaruar, në qoftë se kishit një nje kredi takse që dëshiron ta përdorësh në 730 e ri.

Kujdes: informohu për çdo vit mbi afatet e paraqitjes së modelit 730.

Përmbledhje:



**NË QOFTË SE NUK JAM NJË PUNONJËS I NDËRVARUR,
APO NJË PENSIONIST (MODELI I VETËM)**

Kush duhet të përdorë modelin Unik?

Në qoftë se nuk je një punonjës i ndërvarur ose një pensionist dhe në vitin e kaluar ke marrë një të ardhur, duhet të paraqesësh modelin Unik. Modeli Unik përmban, përveç deklaratës për të ardhurat, edhe deklaratën vjetore të kontributeve Iva si dhe deklaratën Irap. Kontribuesit që zhvillojnë aktivitete të cilat janë aprovuar nëpërmjet

studimesh mbi atë sektor, duhet të plotësojnë një model të posaçëm për të shënuar të dhënat e duhura me qëllim aplikimi për studim.

Duhet kujtuar që duhet përdorur modeli që publikohet çdo vit dhe që mundet ta gjejsh edhe pranë Zyrave të Agjencisë së Hyrjeve.

Mos harro që deklarata duhet të firmoset nga ty ose nga një përfaqësues legal, në të kundërt nuk ka vlerë (është asgjë).

Si duhet paraqitur deklarata?

Deklaratat paraqiten:

- direkt, nëpërmjet shërbimit INTERNET;
- pranë një zyre postale, pranë një banke (në qoftë se nuk ke partita IVA);
- nëpërmjet një ndërmjetësi (profesionistë, Caf dhe subjekte të tjera njohëse);
- nëpërmjet Zyrave të Agjencisë së Hyrjeve (vetëm deklaratat e Modelit të Vetëm Persona Fizikë).

Kujtohu të ruash dokumentin e marrë që zyrat do të të japin.

Afatet e modelit Unik

Kujdes: informohu çdo vit mbi afatet e prezantimit të modelit UNIK, si dhe afatet e pagesave të taksave.

Zgjedhja për destinacionin e 8 për mijë të Irpef (mod.730 dhe mod. Unik)

Mundet të zgjedhësh të destinuarën 8 për mijë të Irpef të konfesionit besimtar, për arsye humanitare apo besimtare, ose për Shtetin, për qëllime me karakter shoqëror apo humanitar.

Të bësh këtë zgjedhje është e lehtë: mjafton që të vësh firmën në një format të caktuar, në krah të Institucionit që ke zgjedhur.

Pranohet vetëm zgjedhja e një institucioni.

Studimet e sektorit ose parametrat

Në qoftë se ke një ndërrmarje të vogël ose mesatare, ose zhvillon një aktivitete pune të pavarur, me fitime që nuk e kalojnë shifrën prej 5.164.569 euro, (7,5 milion euro nga 2007) sëbashku me deklaratën e të ardhurave, duhet të komunikosh disa të dhëna që të kërkohen në modelin e dhënë.

Në qoftë se ke vështirësi në plotësimin e modelit, mund ti drejtohesh Zyres.

6. SI BËHET E MUNDUR QË TË PAGUAJ SA MË PAK TAKSA? ZBRITJET DHE ZVOGELIMET

Zbritjet për familjarët mbi ngarkim

Në se jeton në Itali mund të kesh një zvogëlim të taksës mbi të ardhurat në qoftë se ke familjarë në ngarkim.

Janë familjarë në ngarkim personat që kanë të ardhura që nuk superojnë më shumë se në euro 2,840,51 dhe hyjnë në këto kategori, edhe pse jetojnë jashtë shtetit:

- bashkëshorti (ja) jo legalisht i (e) ndarë;
- fëmijët, si ata që janë të njohur nga ana naturale, të adoptuarit, të besuarit.

Në këtë rast duhet të kesh një certifikatë të lëshuar nga Bashkia e personit që jeton jashtë shtetit që nga momenti kur rezulton gjendja familiare. Certificata duhet të jetë e përkthyer në italisht dhe e vulosur nga Konsullata italiane jashtë shtetit.

Janë familjarë në ngarkim vetëm kur jetojnë me ty ose marrin nga ty një pagesë ushqimore:

- prindërit;
- gjyshërit;
- bashkëshorti(ja) e ndarë;
- dhendri,nusja dhe vjehrrët;
- vëllezer dhe motra;
- femijët e fëmijëve.

Zbritja për fëmijët në ngarkim duhet të ndahet ndërmjet teje dhe bashkëshortit(tes) tënd që nuk duhet të jetë në ngarkimin tënd. Në qoftë se bashkëshorti(ja) është në ngarkimin tënd, atëherë kjo zbritje të takon vetëm ty.

Kini kujdes: qytetarëve jo banues nuk ju bëhen zbritjet për familjarët në ngarkim

Zbritje të tatimet prej për 19%: shpenzime mjekësore, interesa pasive mbi kreditë për blerjen e shtëpisë së parë, shpenzime për shkollim

Ke të drejtë për një përfitim zbritjeje prej 19% për shpenzimet shëndetësore, interesat pasive mbi kreditë e shtëpisë të para si dhe për riparimin e ndër-

tesave edhe pse janë të ndryshme nga shtëpia e parë, të nënshkruar në 1997, interesat pasive mbi kreditë e nënshkruara duke filluar nga 1998 për ndërtimin, apo rindërtimin e e banesave të para, interesat pasive për borxhet dhe kreditë agrare, shpenzimet funeber, taksat shkollore dhe shpenzime të tjera.

Shpenzimet shëndetsore

Për shpenzimet shëndetsore, të cilatdo tip (mjekësor/të përgjithshëm, specialistike, kirurgjike, farmaceutike,, etj.) ke të drejtë për të patur një zbritje takse për 19% mbasi të kesh hequr shumën e 129,11 euro. Duhet të mbledhësh të gjitha shpenzimet e bëra dhe të zbresësh 129,11 euro: zbritja që të takon do të jetë 19% e vlerës së mbajtur. Në qoftë se shpenzimet e bëra gjatë vitit nuk superojnë shifrën e 129,11 euro nuk ke të drejtë për asnjë lloj zbritjeje.

Interesa pasive mbi kreditë

Ligji këtu është pak i ndërlikuar. Zbritja aplikohet mbi interesat që duhet ti paguash bankës. Ke të drejtë të përfitosh në këtë zbritje vetëm kur blen shtëpisë e parë dhe vlera maksimale e interesit mbi kredinë që trajtohet nuk duhet të jetë superiore në euro 3.615,20 pra reduktimi nuk mund të jetë në euro 689,89, e barabartë me 19% të euro 3.615,20.

Mundet të përfitosh zbritje për 19% për blerjen e shtëpisë së parë në qoftë se:

- ndërtesa është përdorur si banesë kryesore brënda një viti nga momenti kur është blerë;
- blerja e ndërtesës duhet të kryhet brënda një viti (para apo mbrapa) nga nënshkrimi i kontratës së kredisë të ipotekuar.

Kjo do të thotë që më parë mundet të blesh dhe brënda një viti të nënshkruash kontratën e kredisë, ose më parë të nënshkruash kontratën e kredisë, dhe brënda një viti të nënshkruash kontratën e blerjes.

Shpenzime për shkollim

Edhe për shpenzimet që duhet të paguash për të frekuentuar kurse për shkollat e mësim dhënies dytësore apo të universitetit, mundet të përfitosh një zbritje për 19% të vlerës së shpenzuar.

NB: PËR SHPENZIMET MJEKËSORE DHE PËR ATO TË SHKOLLIMIT KE TË DREJTË PËRFITIMI EDHE KUR KE KRYER SHPENZIME PËR FAMILJARËT MBI NGARKIM.

Zbritje për shtëpisë e parë

Nëse je pronar i banesë ku jeton ke të drejtë për një zbritje të të ardhurave përballë taksave të zmadhuar prej 5%. Nëse nuk nje fitimi katastal mund ti drejtohesh zyrave të Agenzia del Territorio.

NB: ZBRITJA TË TAKON NËSE JE BANUES NË ITALI.

Shtesë page periodike për mbajtjen ekonomike të bashkëshortes së ndarë apo të divorcuar

Në qoftë se je i ndarë apo i divorcuar, ke të drejtë që të zbriten nga të ardhurat shifrën e çekut për mbajtjen ekonomike që lëshon perioidikisht për bashkëshortin tënd, edhe pse banon jashtë shtetit. Ndërsa nuk mundet të konsiderosh shumën që jep për mbajtjen e fëmijëve të tu.

Kontribute pensioni ose asistence

Në qoftë se një punonjës i pavarur apo një sipërmarrës, duhet të derdhësh kontribute parashikuese dhe asistuese të parashikuara nga ligji për të garantuar pensionin. Në qoftë se je punëdhënës (ke atë të punëtorëve të tu) duhet ti paguash punëtorit rrogën dhe duhet ti derdhësh Shtetit kontributet parashikuese dhe asistenciale që i takojnë. Kur plotëson deklaratën mund të heqësh nga të ardhurat e tua si ndërmarrës, apo si punonjës i pavarur, shifrën që ke derdhur për këto kontribute. Në qoftë se ke një punëtor shtëpie, mund të zbresësh nga të ardhurat përmbledhëse kontributet e derdhura me një limit, maksimumi euro 1549,37.

7. BLE NJË SHTËPI: KAM KUSHTE LEHTËSUESE?

Nëse bleni shtëpi, duhet të paguani taksën e regjistrimit **ose IVA** dhe taksat e ipotekës dhe të kadastrës. Po qe se blini një shtëpi nga një ndërmarrje “**ndërtuese**” (ose nga ajo që rristrukuar shtëpisë) dhe blerja bëhet brenda 4 viteve nga mbarimi i punimeve; duhet të derdhni:



- Iva 10% për çmimin e blerjes. Në qoftë se ble shtëpisë e parë do të kesh një lehtësim sepse mund të paguash Iva 4% dhe jo 10%;
- Taksën e regjistrimit në masë fikse: 168 euro;
- Taksën ipotekare në masë fikse: 168 euro;
- Taksën katastale në masë fikse: 168 euro.

Në raste të tjera (p. sh. blerja nga një privat, nga një ndërmarrje “jo ndërtuese”, ose nga një ndërmarrje ndërtuese që punimet i ka përfunduar më parë se 4 vjet para, taksat duhet ti derdhësh duke llogaritur vlerën katastale të banesës, dhe janë:

- taksa e regjistrit 7%.Edhe në këtë rast, në qoftë se je duke blerë shtëpisë tënde të parë, ke një lehtësim, sepse mund të paguash 3% të taksës së regjistrit dhe jo 7%;
- taksa ipotekare 2%.edhe në këtë rast është parashikuar një përjashitim, në qoftë se trajtohet për shtëpisë tënde të parë , sepse duhet të paguash taksën në masë fikse (euro 168);
- taksa katastale 1%.edhe në këtë rast është parashikuar një përjashitim, në qoftë se flitet për shtëpisë tënde të parë, sepse duhet të paguash taksën në masë fikse (euro 168).

E blerë nga një privat, nga një ndërmarrje jo ndërtuese ose një ndërmarrje ndërtuese që ka përfunduar punimet më shumë se 4 vjet para		
	SHTËPIA E PARË	TË TJERA
REGJISTRIT	3%	7%
IPOTEKARIA	168 euro	2%
KATASTALJA	168 euro	1%
Blerje nga një ndërmarrje ndërtimi (ose që ka ristrukturuar banesën) dhe e shet brenda 4 vjetëve nga përfundimi i ndërtimeve		
IVA	4%	10%
REGJISTRIT	168 euro	168 euro
IPOTEKARIA	168 euro	168 euro
KATASTALJA	168 euro	168 euro

Blerja e shtëpisë së parë

NB: PËR TË PATUR KËTO LEHTËSIMET DUHET TË VERIFIKOSH QË:

1. banesa nuk ka karakter luksoz;
2. ndërtesa duhet të jetë në Bashkinë ku banon (ose atje ku kërkon të stabilizohesh brenda 18 muajve nga kontrata e shitjes) ose, ndryshe, në atë vënd ku ti zhvillon një aktivitet. Në qoftë se je një qytetar që banon jashtë shtetit që, dmth, se je shkruajtur ne AIRE), duhet trajtuar më parë për shtëpisë e parë që është e marrë në territorin italian.

Përveç kësaj në aktin e blerjes duhet të deklarosh:



- që nuk ke pronësi, përdorim, përfitim dhe banim në shtëpi të tjera banuese në territorin e Bashkisë, ku gjendet shtëpia që kërkon të blesh;
- që në Itali nuk ke të drejta pronësie, përdorimi dhe përfitimi, banesë apo një pronësi, mbi një shtëpi tjetër të blerë me këto lloje lehtësimesh;
- që impenjohesh për tu transferuar brenda 18 muajve në Bashkinë ku gjendet shtëpia dhe që dëshiron ta blesh.

8. DHE NË QOFTË SE E MARR ME QIRA? (QIRA TË KONVENCIONUARA)

Në qoftë se je qiramarrës i një shtëpie që përdor si banesë kryesore, dhe se të ardhurat e tua të përgjithëshme janë më të ulta se Euro 30,987,41 mundet të kesh lehtësime (zbritje), që duhet ti shënosh në deklaratën e të ardhurave. Në qoftë se kontrata e shtëpisë është në emrin edhe të bashkëshortit tënd zbritja ju përket 50% për secilin.

Kujdes: për të patur zbritje të taksës duhet që kontrata e shtëpisë të jetë nënshkruar sipas normativës relative me kontratat konvencionale, që dmtb, të nënshkruara nëpërmjet organizatave të pronarëve dhe organizatave të qiramarrësve.

Për të verifikuar në se të takojnë lehtësime, duhet të lexosh kontratën e qirasë dhe të shohësh në se i reforohet ligjit n. 431 të 1998. Kujtohu që zbritja e taksës vlen vetëm për kontratat e nënshkruara në zonat ku ka një urbanizëm të lartë (si psh në qytetet kryesore të rrethit).

Masa e zbritjes është kjo që vijon:

- 495,80 euro Në se të ardhurat tuaja nuk e kalojnë shifrën prej € 15.493,71;
- 247,90 euro Në se të ardhurat tuaja e kalojnë shifrën prej € 15.493,71 (deri në € 30.987,41).

9. JAM PRONAR I NJË SHTËPIE: DUHET TË PAGUJ TAKSA MBI SHTËPISË?

Në qoftë se je pronar, ose ke përdorur banesën e një shtëpie duhet të paguash Irpef dhe nënshesat e Irpef. Duhet që për ketë të deklarosh të ardhurat e një shtëpie në deklaratën e të ardhurave (në kuadrin RB). Për të individualizuar të ardhurën për ta shënuar në deklaratë, duhet të aplikosh tarifën e vlerësimit që ndryshojnë sipas Bashkisë në të cilën ndodhet shtëpia dhe në raport me karakteristikat në të cilat ndodhet si ndërtesë. Për të gjetur këto të dhëna mund ti drejtohesh Agenzia del Territorio. Duhet, edhe, paguar në Bashki ku gjendet shtëpia, l'ICI, ose siç thuhet taksa komunale mbi shtëpisë.

NB: NË QOFTË SE BANON NË SHTËPISË KU JE SI PRONAR APO ATY BANOJNË FAMILJARËT E TU (SHIH KAP 6)
KUJTOHU QE NËSE NUK JE BANUES NË ITALI, LEHTËSIMET NUK TË TAKOJNË.

10. AGJENSIA E HYRJEVE: SHËRBIME, INFORMAZIONE DHE ASISTENCË

Zyrat e Agjencisë të Hyrjeve - në sektorin relativ në Hapësirën Shërbime - mundën të të japin të dhëna dhe të të asistojnë për çfarëdo lloj problemi.



Mund të gjeni zyrën sipas vëndbanimit duke telefonuar në 848.800.333 (shërbim automatik) ose mund të konsultoni sitin: www.agenziaentrate.gov.it, duke klikuar mbi “Trova l’Ufficio”.

Përveç kësaj, në të gjitha zyrat e Agjencisë kryhet një shërbim që të lejon të prenotosh një takim pranë Zyrës me një funksionar, kështu mundet që të evitosh radhat e panevojshme.

Të gjesh informacione më të gjëra mbi të drejtat e tua si dhe mbi shërbimet që Agjencia të ofron.

Për të prenotuar një takim pranë Zyrës së Tatimeve duhet të telefononi në numurin 199126003 ose të lidheni nëpërmjet internetit në sitin e Agjencisë së Tatimeve (www.agenziaentrate.gov.it)

Shumë Agjenci mund t’ju asistojnë dhe në banesën tuaj nëse bëni pjesë në kategoritë e mëposhtme (të paaftë fizikisht, ose mbi 75 vjeç).

Nëse dëshëroni të informoheni nëpërmjet telefonit (informacione për llogaritje në modelin 730, për Modelin Unik, për derdhjen e të hollave, për llogaritjen e pagesës së taksës së makinës, etj) mund të telefononi në këto numra:

- 848.800.444:
përgjigjen punonjësit e Qendrës së asistencës telefonike, në oraret nga e hëna deri të premte, 9.00 – 17.00 dhe të shtunë, ora 9.00 – 13.0
- 199.126.003:
për të telefonuar kur doni të lini takim me zyrat lokale

Për më tepër, mund të konsultoni sitin www.agenziaentrate.gov.it, për informacione fttimore, modele kërkesash, mbi normativën në fuqi, shërbime online (si p. sh. Pagesa e taksave, kërkesë për dublikat, kod tatimor dhe taserinë shëndetësore).

Ju kujtojmë sëfundi që, në “Kartën e Shërbimeve”, që gjendet pranë çdo zyre lokale të Agjencisë së Hyrjeve si dhe në internet: www.agenziaentrate.gov.it, mund të gjeni informacione të mëtejshme mbi të drejtat tuaja dhe shërbimet që ju ofron Agjencia.

Traduzione a cura di:
Sabina Darova, Ilir Polena

GUIDA FISCALE PER GLI STRANIERI

A cura della Direzione Centrale Servizi ai Contribuenti e Relazioni Esterne
in collaborazione con la Direzione Regionale del Piemonte.

Traduzione a cura dell'Associazione "Tante Tinte", agenzia di mediazione interculturale
www.tantetinte.it

Questa pubblicazione tradotta in albanese, è distribuita gratuitamente,
fino ad esaurimento, dall'Agenzia delle Entrate.

Aggiornata con la normativa in vigore al 10 ottobre 2006.

Per ulteriori informazioni e aggiornamenti: www.agenziaentrate.gov.it